

- Planifikimin e investimeve mbështetur në zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkimi European, ku Këshilli i Qarkut është partner në katër projekte për të cilat aktualisht janë nënshkruar kontratat dhe do të fillojë implementimi i tyre. Gjithashtu Këshilli i Qarkut ka ndërmarrë nismën e investimit me projekte të vogla në Bashkitë e Qarkut sipas kërkesave të tyre, duke miratuar me Vendim të Këshillit financimin e 5 objekteve në Bashkitë e Qarkut me një vlerë totale prej 14.5 milion leke për vitin 2018. Investime të kësaj natyre do të vazhdojnë edhe në tre vitet e Programit buxhetor afatmesëm 2019-2021. Në total investimet kapin rreth 35 % të buxhetit në tre vitet e ardhshme.
- Shpenzimet për personelin, parashikimi u bë në mbështetje të numrit të punonjësve të planifikuar me ligj, shpenzimet për paga dhe sigurime kapin rreth 40% të buxhetit.
- Në parashikimin për shpenzime operative u mbështetëm në realizimin e shpenzimeve të viteve të kaluara dhe parashikimin e shpenzimeve administrative më të domosdoshme për funksionimin e Institucionit. Shpenzimet operative zënë 25% të buxhetit.

Ky program buxhetor afatmesëm, është i balancuar (të ardhurat =shpenzimet).

Ana VERUSHI

Kryetar i Këshillit të Qarkut

